



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 11.9.2023

Nr: 768

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**CAKTIMIN E KOHËS SË TRANSMETIMIT NË RADIOTELEVISIONIN PUBLIK TË FUSHATËS
ZGJEDHORE TË PARTIVE POLITIKE TË REGJISTRUARA SI SUBJEKTE ZGJEDHORE, PËR
ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “ë” dhe “n”, e 2, neneve 80, 81, 84 dhe 84/1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

V Ë R E J:

Neni 80, pika 1, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se radiotelevizioni publik vë minutazh falas në dispozicion të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore dhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të bërë fushatë.

Në zbatim të nenit 80, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve cakton minutazhin për partitë parlamentare, sipas numrit të vendeve në Kuvend që ato kanë marrë në zgjedhjet e fundit, si dhe për partitë joparlamentare.

Partive parlamentare, të cilat në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, KQZ-ja i cakton një minutazh të barabartë prej jo më pak se 30 (tridhjetë) minutash në televizionin publik dhe po aq në radion publike. Për partitë e tjera parlamentare kjo kohë është jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) minuta.

Çdo parti joparlamentare që merr pjesë në zgjedhje, përfiton 10 (dhjetë) minuta në televizionin publik dhe 10 (dhjetë) minuta në radion publike.

Data: 11.9.2023 Nr: 768
Ora: 12:00



“Për caktimin e kohës së transmetimit në radiotelevizionin publik të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

Bazuar në nenin 80, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka përllogaritur kohën në dispozicion të subjekteve zgjedhore, duke u bazuar në regjistrimin e tyre për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023.

Me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, Komisioni Rregullator ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.4.2021, duke përcaktuar numrin e mandateve të fituara nga secili subjekt zgjedhor. Duke u bazuar në numrin e mandateve të fituara në zgjedhjet e fundit për Kuvendin, rezulton se:

Partitë parlamentare, të cilat në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më shumë se 20% të vendeve në Kuvend dhe janë regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023, është Partia Socialiste e Shqipërisë.

Partitë e tjera parlamentare që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më pak se 20% të vendeve në Kuvend dhe janë regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023, është Partia e Lirisë.

Duke analizuar nenin 80, pika 1, shkronja “b”, të Kodit Zgjedhor, minutazhi falas ju vihet në dispozicion partive politike të regjistruara apo koalicionit, bazuar në parimin e proporcionalitetit të numrit të konkurrentëve në garë. Konkurrenca politike në garë matet nga numri i subjekteve zgjedhore të cilat kanë dorëzuar kandidatët për kryetar bashkie dhe listat shumemërore për kandidatët për anëtar të këshillave bashkiakë.

Si subjekte zgjedhore pjesëmarrëse për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023, janë regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve edhe parti politike joparlamentare që konkurrojnë më vete apo si parti pjesëtare në koalicione, të cilat në zbatim të nenit 80, pika 1, shkronja “c”, të Kodit Zgjedhor, përfitojnë 10 minuta në televizionin publik dhe 10 minuta në radion publike.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronjat “ë” dhe “n”, e 2, nenet 80, 81, 84 dhe 84/1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

V E N D O S:

1. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 50 (pesëdhjetë) minutash në televizionin publik dhe 30 (tridhjetë) minutash në radion publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

2. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 25 (njëzetë e pesë) minutash në televizionin publik dhe 15 (pesëmbëdhjetë) minutash në radion publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të partisë parlamentare “Partia e Lirisë”.
3. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 10 (dhjetë) minutash në televizionin publik dhe 10 (dhjetë) minutash në radion publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të partisë joparlamentare “Partia Demokristiane e Shqipërisë”.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI